



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština – Municipality of Prishtina



## EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

i mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 28.12.2023, duke filluar në orën 8:30.

**Në mbledhje morën pjesë:** Pëllumb Bajçinovci, kryesues i komitetit, anëtarët e komitetit: Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Arbnora Berisha, Gëzim Sveçla, Nora Kelmendi, Bahri Gashi dhe Mirsad Vitia.

**Munguan:** Shegë Beqiri dhe Leutrim Retkoceri.

**Në mbledhje ishin të pranishëm edhe:** Përparim Rama - Kryetar i Kryeqytetit, Alban Zogaj - Nënkyetar i Kryeqytetit, Osman Bllaca, Mimoza Sylejmani – drejtoreshë e Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Bujar Çunaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Pëllumb Bajçinovci - kryesues i komitetit, me këtë:

### REND DITE

1. Miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënie në shfrytëzim për vitin 2024;
2. Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm “Zona Ekonomike” në Prishtinë.

Para se të fillonin me diskutimet për pikat e rendit të ditës, Bahri Gashi shprehi shqetësimin se nuk ka qenë i informuar për takim dhe materiali nuk i është hapur.

**Kryesuesi:-** tha shumica e kemi marrë materialin dhe ka qenë një material shumë i ngarkuar e kemi ndarë në tri pjesë, kishim mundur që na me shtyp dhe ju ta merrni te ne materialin se me të vërtetë ka qenë një material i shumë i vëllimshëm.

**Bahri Gashi:-** tha, po ashtu nuk është një funksionim i mirë në të njëjtën ditë me qenë edhe KPF në ora 8:30 e në ora 10:00 seanca e Kuvendit, sa herë po ndodh kështu, nuk ka kuptim me një material prej 5 mijë pronave me gjithë ato fleta poseduese për tri ditë me pas seancë të jashtëzakonshme. Për mua ky takim është i pavlerë.

**Përparim Rama:-** sa i përket volumit të pronave e kam pa të rendit që m’i hap mundësinë p.sh për gjitha pronat e Kryeqytetit që janë të gatshme në këtë rast ne mundemi m’i përdor në zhvillim të Kryeqytetit në qoftë se ekziston nevoja për zhvillim të një pike apo pikë tjetër as unë nuk e di ku janë këto dhe si janë këto prona, mirëpo nëse i kemi të hapura për shqyrtim, sqarim mi pas të hapura jo mi pas pronat e mos me

mundur me i shfrytëzuar deri në vitin e ardhshëm. Pra me hup një vit për arsye që nuk i kemi mundësuar të shkojnë në aspektin procedural, kjo është ideja vetëm me mundësuar zhvillimin e proceseve të transformimit të kryeqytetit.

**Kryesuesi:-** duke u ndërlidhur me fjalimin e Bahriut tha se kemi të bëjmë me një seancë të jashtëzakonshme dhe zakonisht seancat e jashtëzakonshme vinë me pikat e rendi të ditës, të cilat janë me urgjencë me pjesën tjetër. Seancën e kemi lajmëruar 3 ditë më herët në atë formën ligjore e cila e mundëson se nuk ka pas kohë tjetër se jemi në fund të vitit dhe është takimi i fundit për me kaluar një pikë e cila nëse nuk kalon këtë vit kalendarik atëherë e humbim edhe vitin tjetër për t'i dhënë në shfrytëzim pronat. Sa i përket seancave të rregullta pajtohem me juve se duhet të ekzistojë një afat kohor në mes të KPF-se dhe seancës së Kuvendit.

**Bahri Gashi:** - theksoi se për seancë të jashtëzakonshme nuk ke nevojë ta thërrisni komitetin.

**Kryesuesi:-** tha e kemi diskutuar edhe këtë pjesë, por për shkak të bashkëpunimit më të mirë po mundohemi me krijuar këtë urën për temat të cilat me të vërtetë janë të rëndësishme për komunitetin.

**Gëzim Sveçla:-** tha materialin e kemi marrë pardje gjë që është në kundërshtim me ligjin. Ligji thotë materiali duhet të dërguar tri ditë përpara në procedurë administrative, nuk e di pse ka ndodh kjo që tri ditë para Vitit të Ri të vijnë gjithë ato prona, a i keni shikuar ato prona a janë prona të lira, a kanë konteste gjyqësore apo vetëm i kemi fut aty?, a kemi me votuar ne sot për prona që nuk dihet a janë të uzurpuara, nuk dihet a kanë konteste gjyqësore, si do të mundemi ne t'i kontrollojmë mbi 5 mijë fletë poseduese.

## **Pika e parë**

### **Miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024**

**Bujar Çunaku:-** në pika të shkurta informoi për listën e veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024, ku ceku se në bazë të Ligjit dhe akteve nënligjore për dhënien në shfrytëzim të pronës dhe Ligjit për Qeverisje Lokale për menaxhimin e pronave Drejtoria e Pronave ka përgatit listën e veçantë për dhënien e pronave në shfrytëzim për vitin 2024.

**Alban Zogaj:-** tha keni të drejt çka po diskutoni, ne e kemi vërejt në dy vitet e para kjo lista e veçantë e pronave në vend se të bëhet mekanizëm që të na ndihmojë në mekanizëm të proceseve është bërë mekanizëm kufizues i proceseve, sepse vjen një palë e interesuar, vjen një organizatë e interesuar për një pronë të caktuar dhe ti nuk e ke listën e veçantë dhe kesi soji je i kufizuar me vazhduar tutje me proceset. Ne këtë vit kemi vendosur për mos me e kufizuar na veten, për mos ta kufizuar organizatën tonë i kemi futur krejt pronat që i kemi në dispozicion në listë.

**Bahri Gashi:-** tha a e lejon Ligji për me fut në listë pronën e uzurpuar.

**Alban Zogaj:-** dha sqarime për çështjen e parashtruar nga parafolësi, po ashtu theksoi se po dëshirojnë me hap derë dhe kështu e hapim derën me bashkëpunim me të tjerët dhe kjo listë e veçantë mos me qenë listë kufizuese, por me qenë listë që na jep mundësi.

**Gëzim Sveçla:-** ky është vizioni, nuk mundemi ne me gjykuar as me vlerësuar vizionin që e keni ju, por tani për me realizuar një pjesë të vizionit të juaj ka një procedurë të caktuar, për me kaluar atë procedurë pjesë e procesit jemi edhe ne prej kësaj ane, ky proces i ka disa hapa, të cilët duhet respektuar, kurse një

prej hapave është verifikimi i listës dhe nuk kemi mundësi certifikatat e pronave në kohën prej 48 orëve me i kontrolluar.

**Alban Zogaj:-** tha ne si ekzekutiv i kemi besuar Drejtorisë së Pronave në këtë proces dhe kemi hyrë me një besim të plotë dhe ju kemi thënë identifikoni pronat komunale e pastaj futni në listë.

**Gëzim Sveçla:-** pyeti se a jeni në dijeni se në listë ka prona të cilat komuna i ka dhënë në shfrytëzim, se ato përdoren edhe për biznese të ndryshme, por që kanë një kontratë valide prej komunës duke shtuar se a paraqet siguri për ata investitorë, të cilët veç janë në shfrytëzim të pronave komunale e ato prona janë në listë.

**Alban Zogaj:-** dha sqarime për çështjen e cekur nga parafolësi.

**Bujar Qunaku:-** tha vetëm nëse ka ndodhë ndonjë gabim i natyrës teknike por qëllimshëm nuk ka hyrë asnjë pronë që është dhënë tani në shfrytëzim ose është dhënë në shfrytëzim më herët.

**Gëzim Sveçla:-** pyeti a ka prona të Zonës ekonomike në Fushë Kosovë dhe ka një vendim të Kuvendit komunal dhe për vazhdim edhe për 1 vit që është një rekomandim që ka ardhur prej komisionit.

**Bujar Qunaku:-** u përgjigj duke shtuar se po janë me kontratë të skaduar.

**Bahri Gashi:-** tha çka mendoni nëse shkon debati fletë për fletë ku është ajo pronë, çka përmban ajo pronë, kush është në atë pronë, çka është destinacioni jo sipas planit rregullativ ose planit të projektimit ku janë afër 5 mijë prona në lista, hiqni prej listave bëni kontrata, marrëveshje me ta.

**Gëzim Sveçla:-** tha ka prona të zonave rurale që për vite punohen dhe shfrytëzohen prej banorëve lokal, kurse pyeti se a e dini çfarë pasigurie paraqet kjo në fshatrat Ballaban, Koliq, gjitha janë prona të komunës.

**Alban Zogaj:-** tha pas kësaj na e kemi vetëm një problem që nëse nuk e votojmë sot këtë listë na vitin e ardhshëm mbesim pa prona për shfrytëzim, e humbim një vit, ju e keni në dorë Kuvendin komunal me votuar pikën, ju veproni.

**Nora Kelmendi:-** theksoi se sa herë i ka thënë Doruntinës se duhet me sjell listën e veçantë të pronave, pse tani e keni sjell në moment të fundit, unë personalisht merrem me prona nuk kam mundur me shikuar asnjë, kurse janë 5 mijë prona, pse nuk e keni sjell në tetor, nëntor nuk është e thënë vetëm në dhjetor me sjell listën, e kishim përgatit i kishim kontrolluar. Po ashtu as komisionin nuk e keni të formuar për dhënien në shfrytëzim të pronave që është dashur në fillim të mandatit me u formuar.

**Alban Zogaj:-** tha ndoshta asnjë pronë nuk e japim në vitin 2024, nuk do me thënë gjitha m'i dhënë, ndërkaq komisionin e formojmë, ne mund të krijojmë komisione edhe komisione Ad hoc.

**Gëzim Sveçla:-** tha është çështja te procedura, te qasja, problemi është te qasja, është rregull vizioni dhe mendësia, por ka procedura që duhet m'i respektuar që me arrit deri te kjo. Ka Ligje të caktuara unë mendoj vetëm emrin e ka kjo e jashtëzakonshme se lista nuk është e jashtëzakonshme, listë që 12 muaj kemi pasur mundësi me përgatitur dhe me ardhur këtu.

**Jeta Rafuna:-** tha me Norën pajtohem gjithqysh që në seancën e radhës të janarit m'u formuar Komisioni për dhënien në shfrytëzim të pronave prej Kuvendit komunal.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Miratimi i listës së veçantë të pronave që planifikohen për dhënien në shfrytëzim për vitin 2024 dhe dërgohet në Kuvend për miratim.**

## **Pika e dytë**

### **Propozim-vendimi për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona Ekonomike" në Prishtinë**

Lidhur me **Propozim-vendimin për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm "Zona Ekonomike" në Prishtinë**. Në pika të shkurta informoi Mimoza Sylejmani duke cekur se në seancën e kuvendit ato që i kemi diskutuar i kemi larguar dhe tash e ka emrin Campusi sportiv, i cili do të shtrihet komplet, do të revidohet Zona ekonomike që ka 697 ha dhe që janë shtuar edhe 120 ha.

**Gëzim Sveçla:-** theksoi se në seancë i kam bërë disa pyetje: sa është prona private brenda këtij 120 ha që po shtohet si pjesë e planit. Po ashtu në seancë u diskutua se pjesa e arsyetimit ishte që ka një marrëveshje me Qeverinë a u sqarua se nuk ka marrëveshje.

**Mimoza Sylejmani:-** tha e ka sqaruar kryetari se nuk ka marrëveshje, unë nuk kam qenë pjesë e debatit, takimeve me Ministrinë, por i kam marrë informatat ashtu si i ka cek edhe kryetari.

**Gëzim Sveçla:-** pyeti sa është hapësirë private brenda 120 ha dhe prej hapësirës ekzistuese të asaj Zone ekonomike që i pati 600 ha sa janë të shfrytëzuara për momentin prej Komunës së Prishtinës.

**Mimoza Sylejmani:-** tha ne për me filluar revidimin e planit, zakonisht deri tani i kemi përcaktuar vetëm kufijtë e zonave, nuk kemi hyrë në detaje dhe kur të sillët për shqyrtim publik aty shkojmë me detaje dhe me prona, ndërsa kur të planifikohet nuk i shikojmë pronat e kujt janë.

**Gëzim Sveçla:-** tha nuk po më duket në rregull me marrë vendim për me reviduar planin pa e ditur në pronat e kujt po shkojmë.

**Mimoza Sylejmani:-** tha zakonisht kur planifikohet nuk dihen pronat e kujt po shkojnë, vetëm e hedhim një kufi, nuk e dimë sa janë prona private.

**Alban Zogaj:-** tha drejtoreshë këtu janë dy qasje: një qasje si po thua ti kur ti e hedh hartën bllanko dhe nuk kujdesesh për stakeholders dhe i bënë planet, por qasjet moderne është me i shikuar stakeholders me shikuar kend po e prek se është shumë me rëndësi se qysh do ti me planifikuar në bazë të stakeholders dhe me ua marrë edhe atyre mendimet, çfarë plane kanë edhe ata.

**Gëzimi Sveçla:-** tha a e di përafërsisht sa është pronë private, a mundem para seancës me marrë këtë informatë.

**Alban Zogaj:-** tha ne kur e kemi planifikuar Kalabrinë i kemi marrë parasysh stakeholders, edhe kjo është pyetje shumë valide, është valide se sa ka pronë private në planin që do të bëhet.

**Gëzimi Sveçla:-** tha qysh kemi me kompenzuar atë pronë private?.

**Alban Zogaj:-** tha na duhet me pas kujdes pronën private kur e planifikojmë edhe sa më pak me planifikuar pronën private.

**Kryesuesi:-** tha po kërkojmë përgjigje për pronat private brenda atij kufiri të cilin po e inicojmë ndoshta jo detajet, por me një përqindje të caktuar sa munden me pas aty. Po ashtu ju drejtua zotëri Gashit pasi e përmendëm në fillim seancat e jashtëzakonshme dhe KPF-në, andaj unë tash po deklarohej para juve se nëse e shihni të arsyeshme në seancat e radhës të jashtëzakonshme nuk e thërrasim KPF-në nëse jeni edhe ju dakord apo diskutojmë më herët.

**Gëzimi Sveçla:-** tha unë mendoj se çështja është me të vërtetë e jashtëzakonshme ka nevojë për konsultime në mënyrë që procesi të vazhdojë.

**Bahri Gashi:-** tha ka qenë praktikë e mirë e kemi pasur KPF-në një javë përpara seancave normale, praktikoni materialin ta dërgoni me kohë. Ju lutem kur të ndërroni material, kur drejtoresha e ndërron

materialin duhet me na treguar çka ka ndërruar e jo me shkuar faqe për faqe me shikuar çka ka bërë ndryshim. Andaj po kërkoj që Komiteti me qenë një javë para seancës kur është e mundshme materialet një javë para komitetit, praktikoni mos me fut pika në seanca, sepse po vijmë pa përgatit.

**Kryesuesi:-** tha pajtohem plotësisht edhe kjo detyra dhe përgjegjësia nuk po varen prej meje, po varet prej ekzekutivit, prej drejtorëve.

**Bahri Gashi:-** tha unë e kuptoj edhe brenda seancës me të ardhur diçka e jashtëzakonshme ndodh normal, por me të ardhur 5 mijë fleta poseduese, është problem vetëm me i numëruar.

**Nora Kelmendi:-** tha pa punuar në Komunë as asamblisti nuk e kupton se sa ka volum të madh të punës, ndonjëherë edhe bllokohesh, kurse sa i përket certifikatave të pronës unë po ju garantoj që këto 6 mijë certifikata për dy ditë ishin lëshuar se i kanë në sistem, por nuk ekziston një koordinim i mirë i punës apo bashkëpunim i pronës me kadastrë. Po ashtu e ceku se e ka dërguar një koment për Rregulloren e parkingjeve nuk mundet me qenë 450 me 300, se 300 duhet të bëhet, kurse pyeti se a e keni parë te zona dy është ndryshuar, ndërsa në zonën tre jo.

**Kryesuesi:-** tha për zonën dy ka pasur kërkesë të ndryshohet, ndërsa për zonën tre nuk ka pas kërkesë.

**Osman Bllaca:-** tha ti ke kërkuar për laura.

**Nora Kelmendi:-** unë nuk po them për laura, por kur e ke 30 € a e ke shtuar 30 € në muaj e qysh 450 € në vit.

**Gëzim Sveçla:-**tha në vit duhet me qenë më pak.

**Kryesuesi:-** dha sqarime se pika e tretë është 45 me 450, e kemi shënuar me ngjyrë të kuqe 30 për ta ndryshuar.

**Nora Kelmendi:-** tha, por nuk mundet me qenë 30 me 450.

**Kryesuesi:-** tha e kemi kthyer tani 45 me 450.

*Mbledhja përfundoi në orën 9:30.*

**Procesmbajtësja  
Shyhrete Islami**

**Kryesues i Komitetit  
Pëllumb Bajçinovci**

